

VENDIM
Nr. 212, datë 27.9.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DON-UCD”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”; të nenit 5, pika 1, germa “d”; të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016 dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 27.9.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “DON-UCD” sh.p.k., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “DON-UCD” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 592 prot., datë 17.9.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “DON-UCD” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE, në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”): plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”): plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”): plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”): plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “e” (struktura e ndërtimit të shoqërisë).

Do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ta paraqesë atë në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “DON-UCD” sh.p.k., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti